




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Procesverbal

Nga Seanca e katërbëdhjetë e (XIV) e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 28.2.2011 në sallën e kuvendit të Komunës së Gjiçanit me këtë:

Rend pune:

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e XII dhe XIII e KK-së
2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa
- 2/1- Kriteret themelore për investimet publiko-private në zonat urbane dhe
- 2/2- Propozim- vendimi për aprovimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit dhe komiteteve të KK- Gjiçan për vitin 2011
3. Të ndryshme

Seanca filloi punimet në ora 10. 20 min

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e seancës ishin:

Anëtarët e Kuvendit
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesit e OSB-së
Përfaqësuesit e Kompanisë “Urban plus”
Mediet

Izmi Zeka- para se të fillojmë me punë propozoj që në rend të punës të jetë edhe një pikë e ajo është; Betim solemn i anëtarit të rinj të Kuvendit z. Nevzad Rushiti nga grupi parlamentar i LDK-së i cili e zëvendëson z. Nehat Ramadanin i cili ka dhënë dorëheqje.
Për këtë rast e kemi edhe konfirmimin nga KQZ-ja.

Gjithashtu një shkresë të cilën e dorëzoi Grupi joformal i grave dhe Zyra për Barazi Gjinore dhe e cila iu është shpërndarë anëtarëve të Kuvendit, unë nuk do ta fus në rend të punës, por do ta them fjalën lidhur për këtë rast, por për këtë nuk do të hapi debat.

Së pari kërkoj nga ju që të pajtoheni që në rend pune të jetë edhe Betim solemn i z. Nevzad Rushitit?

Me vota unanime Kuvendi pajtohet që të jetë pikë e parë edhe betimi solemn i z. Nevzad Rushitit

Së pari po ia tërheq vërejtjen sekretarisë së Kuvendit që në asnjë rast, mos t'i shpërndajë letra anëtarëve të Kuvendit pa lejen time! Këtë po e them se këtu në këtë formë mund të shpërndajë letra kush të dojë!

Në vijim të fjalës së tij z. Zeka e lexoi letrën e cila ishte shpërndarë para anëtarëve të Kuvendit, por theksoi se thuhet grupi joformal i grave dhe grupi formal i grave, por askush nuk mund të jenë në të dyja. Duhet të jetë në njërin ose grupin tjetër. KK- e Gjilanit i ka 14 këshilltare komunale dhe është mirë të deklarohen se a janë këto shkresa në emër të tyre, kurse Rrjeti Rinor nuk ka ide për atë se çka shkruhet këtu!

Unë e kam thënë edhe më parë, por po e them edhe njëherë zgjidhni punët në grupet parlamentare të juaja dhe jo në Kuvend! Unë e kam thënë tekstualisht dhe po them edhe njëherë.

Kam thënë dhe i qëndroj asaj se dikush ka ardhur me 50-60 vota prej femrave, por po deklaroj nëse nuk është kështu, atëherë e tregoni? Unë nuk kam bërë fyerje, por e kam thënë një realitet! Unë çdo ditë në KK- nuk kam kohë të merrem me barazi gjinore, me këtë duhet të merren partitë pulitke dhe ato le t' i sjellin emrat. Kur të sillen emrat, unë ata emri i fus në komitete dhe komisione, prandaj edhe një herë po theksoj se unë nuk i caktoj emrat e grupeve parlamentare.

Nëse dikush e ka ndier veten të fyer kërkoj falje publike, femrave këshilltare dhe të gjitha të tjerave për këtë fjalë që e kam thënë. Mirëpo kjo është lodhje e tepërt të merrem me barazinë gjinore në Kuvend e cila çështje nuk është kompetencë e imja. Ju lutem m' i sillini emrat e femrave të cilat ju mendojnë se ku mund të bëjmë ndryshime në të gjitha komitetet.

Ajo që është shkruar këtu nuk është opinion i qytetarëve

Ashtu qëndron çështja edhe me Zyrën për Barazi Gjinore dhe po them këto zgjidhni, nëpër partitë e juaja, sepse unë nuk mund të bëj ndërrime.

Fjalën do ta ketë grupi jo formal i grave

Mimozë Kadriu- faleminderit z. Kryesues që e morët parasysh, kërkesën e grupit, por ju duke desh të justifikohesh, prapë më ofendove, sepse më quajte dekor i këtij grupi, por realisht nuk është kështu. Grupi formal i grave është në vazhdimësi në aktivitete dhe din t' i vlerësojë e din mirë se çfarë aktivitete janë bërë. Grupi joformal i grave pse quhet joformal është, se aktiviteti i jonë është joformal dhe ato vota që na kanë mundësuar të hyjmë edhe ato janë vota, por dikush ka hyrë edhe për pa dal fare në matje. Ju duhet ta keni parasysh ligjin për Barazi gjinore të cilin ju si kryesues nuk guxon për ta shkelur.

Ne kemi kërkuar vetëm të na kërkosim falje, sepse na ke ofenduar me disa fjalë !

Izmi Zeka- unë e thash iu kërkoj falje nëse iu kam lënduar! Mirëpo po e them përfundimisht, partitë politike t' i zgjidhin këto probleme, sepse u zgjatë shumë me këtë punë.

1. Betimi solemn i anëtarit të Kuvendit
Z. Nevzad Rushiti e bënë betimin solemn, para anëtarëve të Kuvendit.

2. Prezenca dhe procesverbali

Sekretaria konstatoi se në punimet e seancës ishin prezent 40 anëtarë të Kuvendit, kurse mungoi 1 (një)- Ejup Haziri

Procesverbali

Sarandë Bllaca- në faqen 10 në diskutimin tim ka mjaft gabime teknike dhe përmbajtjesore në procesverbalin e datës 31.1.2011, por ato vërejtje do t' i dorëzoj me shkrim në sekretari.

Ibish Ibishi- kam mjaft vërejtje se në tërë falën time ka vërejtje, por ato do t' i dorëzoj me shkrim në sekretari.

Shpresë Kurteshi - vërejtjet e mia do t' i dorëzoj me shkrim

Abdyl Aliu – nga sekretaria është thënë edhe për pagesat që bëhen nga operatorët ekonomik, dhe në këtë rast qëndroj prapa kësaj, sepse është konflikt i interesit- të shtohet vetëm pagesat që bëhen për operatorin ekonomik për organin mbikëqyrës, procesverbali 1.2.2001

Aprovohet procesverbali me këto vërejtje

- 3/1- Kriteret themelore për investimet publiko-private në zonat urbane dhe
- 3/2- Propozim- vendimi për aprovimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit dhe komiteteve të KK_ Gjilan për vitin 2011

Izmi Zeka- Komiteti për Politikë dhe Financa ka debatuar, mandej grupi i Ekspertëve, por përsëri është rikthyer dy herë kjo çështje, do të thotë ka kaluar aspektet profesionale dhe procedurale me qëllim që këtë pikë ta sjellim sa më të kompletuar dhe të përgatitur mirë.

Unë nuk do të ndalem gjatë në këtë pikë, sepse ju i keni vendet ku orientimisht janë planifikuar objektet në të cilat do të bëhen investime publiko-private, por janë këtu edhe përgjegjësitë ku do të na informojnë në mënyrë detale se ku janë përcaktuar zonat për investime publiko-private.

Për herë të parë ky Kuvend po arrin ta debatojë një projekt i cili sa është i ndjeshëm, aq është edhe i rëndësishëm për Komunën e Gjilanit. Deri më tash nuk kemi pasur investime të tilla, publiko-private dhe natyrisht kjo nuk është edhe punë e lehtë, por nëse dëshirojmë ta ndryshojmë Gjilanin dhe ta ndërtojmë, duhet të gjejmë edhe mënyra dhe rrugë të cilat janë të rënda fillimisht, por duhet të fillojmë. Jemi ndër komunat e para që po fillojmë me një hap të tillë i cili është hap shumë i guximshëm për të krijuar mundësi për investim.

Me sa di unë janë gjashtë projekte, njëra është te xhamia ku parashihen dy ndërtesa, mandej te Kadastri, pastaj tek Kinemaja dhe ATK-ja, te Magjistralja dhe te Varrezat e qytetit në kahen e majtë dhe më lartë një objekt banues dhe retroaktiv në “Dardani”.

Këto do të jenë edhe objekte edhe banuese, por edhe komerciale dhe objekte për qendra tregtare. Ne i kemi përcaktuar dhe kriteret me të cilat do t' i realizojmë këto objekte për të cilat është punuar mjaft gjatë, ato i kemi në material të cilat janë hartuar nga komitetet profesionale, por në këtë drejtim ka punuar edhe një ekip i ekspertëve, pasta e kemi sjell në Kuvend.

Pasi e tha fjalën e vet kryesuesi e hap debatin dhe kërkon nga këshilltarët që të japin sugjerime dhe vërejtjet e tyre.

Arben Mehmeti- pas vërejtjeve që patët nga grupi joformal të grave, nga ana e jonë keni komplimente, për atë që e miratuat edhe një pikë në të cilën u bë betimi solemn i anëtarit tonë nga LDK. Mirëpo tek pika nën të ndryshme do të paralajmëroj më herët se i kemi edhe dy çështje për debat: njëra është për fushën e arsimit, kurse tjetra për çështje të shërbimeve publike.

Abdyl Aliu- në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së, por edhe në emër të opozitës, kërkoj nga kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka që të distancohet nga një deklaratë e cila është publikuar në gazetën ditore “Kosova sot” më datë 20 shkurt 2011. Në këtë deklaratë ai thotë: “opozita nuk e ka idenë se çka janë investimet publiko-private”. Sikur z. Kryesuesi të kishte deklaruar në emër të tij personal, nuk do të kisha kërkuar një gjë të tillë, por pasi që ai flet në emër të përfaqësuesit të asamblesë komunale, shprehi pakënaqësi për këtë pamaturë në këtë deklaratë të kryesuesit. Unë po ia kujtoj kryesuesit se opozita është shumë e gjerë dhe me një fjalë ajo është deti.

E ngushtë mundet të jetë vetëm mendësia dhe pikëpamjet për të. Ka në opozitë dhe pozitë që brenda ditës i kalojnë me dhjetëra partneritete të ndryshme dhe atë jo vetëm në Kosovë, por edhe në qarqet ndërkombëtare. Ju preferoj z. Kryesues që në raste të tjera kur terreni është i rrëshqitshëm të ecni pak më me kujdes!

Izmi Zeka- ju me këtë rasat më hodhët në terren tjetër në të cilin nuk dua të dal, por po iu them edhe diçka: Derisa kryetari i juaj del edhe prononcohet dhe thotë se :” është diçka mbi pushtetin dhe thotë fjalë fyese dhe deklaroi se do të keqpërdoren dhe do të bëhen kjo ose ajo, atëherë ju ka qenë desh t’ i thoni kryetarit të juaj, se si është gjendja, sepse ne dhe ju jemi në ngjarje. Ka qenë desh që ju kryetarit të partisë t’ ia sqaroni se si është kjo gjendje? Unë e kam thënë se opozita nuk e ka idenë se çka është duke ndodhur, sepse jemi në procedurë!

Fjala publike ka peshë dhe nuk mund dikush të na thotë se është eulexi në Gjilan, kjo ka qenë fjalë e rëndë publike e cila nuk ka mbulesë.

Ju nuk ia keni sqaruar kryetarit të juaj iniciativën për investime publiko-private dhe për këtë arsye ai nuk e ka idenë se çka po bëhet në këtë drejtim?

Sokol Haziri- do të jem shumë i shkurtër dhe i qartë. Më erdhi mirë që e sqaruat pozicionin e juaj dhe LDK-së, sepse ky paska qenë një relacion në mes kryesuesit të Kuvendit dhe kryetarit të partisë të LDK-së dhe kryetarit të PDK-së dega në Gjilan. Sa i përket opozitës të gjithë e dinë se opozitë në Gjilan është edhe AAK dhe LDD dhe nuk përfaqëson opozitën vetëm LDK, por opozitë është secili në atë hisen e vet, prandaj kisha desh që kur diçka thuhet publikisht, gjërat të adresohen qartë. Unë mendoj se sqarimet janë të mjaftueshme dhe mund të vazhdojmë me punë.

Elisah Ymeri- unë në seancën e kaluar kam kërkuar një interpretim ligjor, nga Zyra ligjore përkitazi me kompensimin shtesë për shefat e grupeve parlamentare, por ky interpretim nuk është sjell në Kuvend. Unë e posedoj këtë interpretim dhe shumë mirë sqarohet se ai vendim është në kundërshtim me ligjin. E lus edhe njëherë Zyrën ligjore të na sjell interpretimin ligjor lidhur me vendimin të cilin e kemi marrë?

Naser Sylejmani-lidhur me projektet e PPP-së, bazuar në ligjin për partneritet privat dhe ligjet e tjera që e rregullojnë këtë fushë, me iniciativën e kryetarit të Komunës në bashkëpunim me

Drejtorinë e Urbanizmit dhe sektorëve të tjerë të Komunës janë identifikuar zona të caktuara në pjesët urbane të qytetit, pronë e KK- Gjilan, përveç lokacioni të Kinemasë së qytetit dhe ATK-së ku kemi prona të privatizuar dhe pronë të Qeverisë, kurs lokacionet tjera janë pronë e KK- Gjilan. Lokacionet tjera janë në zonën “Dardania”, ku është propozim zgjidhja urbanistike për objekte rekreativo-sportive dhe afarizëm. Mandej është lokacioni te Drejtoria e Kadastrit, propozim për zgjidhje ideore për objekt afarist –administrativ. Mandej objekti në qendër, zona tek argjendarët, zona tjetër është ish “Magjistranja”. Zona tjetër është tek “Iliria” i cili projekt është që nga viti 2006 dhe ai përballë Kombinatit të Duhanit është projekti ideor afarist. Këto lokacione janë si propozim- projekte.

Arbenita Ymeri- Rexhepi- përfaqësuese e Kompanisë “Urban plus”,
Zonja Rexhepi, të gjitha këto projekte i elaboroi me anë të projektorëve para këshilltarëve komunal.

Jakup Bajrami-unë nuk kam ndonjë vërejtje serioze lidhur me këto projekte, sepse ajo u sqarua nga projektuesi, por edhe materialin lidhur me këto projekte e kemi marrë dy herë. Unë e kam vetëm një pyetje me të cilin kërkoj sqarime: Unë e kam parë në material, ku theksohen kriteret minimale për ndarjen, me përqindje e kam vërejt që te “Dardania” është fut edhe “Arbëria” për të cilin rast do të thotë “Arbërinë” fare nuk kemi debatuar. Unë kisha desh që sot të rekapitulohen të gjitha ato pjesë të cilat jemi duke i debatuar dhe i kemi debatuar dhe do të marrim vendim. Do të ishte mirë që këto gjëra t’ i specifikojmë mirë dhe të dimë se çka po aprovojmë si Kuvend i Komunës. Si projekte publiko-private nuk kam vërejtje as personale, por jam i bindur se edhe grupi i im është për një iniciativë të tillë.

Sabedin Kadriu- unë do të flas në emër timin personal dhe në emër të grupit. Si djalos i ri më kujtohen dy fjali të një politikani të nderuar, Veton Surroi i cili kishte thënë: “ gazetën e lexon gjithkush, por nuk mund ta kuptojë se çka ka në mes rreshtave” dhe thuhet se shpesh duhet parë matanë kodrës i cili fakt më ka ndodh se kam parë matanë kodrës dhe pikërisht më ka dal ashtu si kam parë.

Ne e dimë se në këtë Kuvend tre vjetët e fundit kemi diskutuar për disa projekte, në të cilat projekte shpesh janë vizatuar disa gishta të cilët profesionistët i quanin në formë të gjelbërimit. Në këto projekte për partneritet publiko-privat në vend se të bëjmë gjelbërime ne po bëjmë beton.

Unë edhe si profesionist, agronom nuk mund të pajtohem me këto, por nuk mund të pajtohem edhe me shumë gjëra të tjera, por në rend të parë në pjesën mbi Stacioni e Autobusëve më kujtohet sa kam qenë drejtori i Inspecionit ka pas filluar një objekt dykatësh, por aq më keq i obliguan njerëzit (banorët e asaj lagjeje) ta refuzojnë atë objekte me arsyetim se të hendikepuarit nuk i duam afër! Kjo për mua ishte një mjerim në atë kohë!

Këto ishin deklarata sikur këta njerëz të hendikepuar nuk janë njerëz tanë, por edhe u thoshte se po ngushtohet hapësira për ato banesa të cilat janë ekzistuese.

Tash këtu po shihet se është projektuar banesa 10 kate, prandaj shtrohet pyetja a është në rregull kjo? Për mendimin tim nuk është në rregull! Duke i pasur parasysh të gjitha këto z. Kryesues dhe z. Kryetari i komunës, vota ime do të jetë kundër PPP-së dhe nuk do ta votoj asnjë pikë lidhur me PPP-në, sepse më duket se nuk është në rregull.

Komuna e Gjilanit ka nevojë për shumë gjelbërime, për shumë drunj dhe unë nuk e pash këtu që së paku është paraparë një objekt ose një park sikur ky ekzistues i cili është shumë i vogël.

Nuk janë paraparë objekte kuturoro-artistike dhe aq shumë e kemi ngulfat kulturën, sportin në Komunë të Gjilanit sa që SHKA-të e ndryshme bëjnë ushtrime nëpër podrume dhe në vende të papërshtatshme dhe kjo është arsyeja që asnjë objekt lidhur me PPP-në nuk do ta votoj, ndoshta e kam gabim, dëshiroj ta kem gabim, por ky është qëndrimi im.

Florinë Zymberi – si kryesuese e komiteti përkatës do t' i them disa gjëra në pik atë shkurta. Të gjitha këto projekte janë shqyrtuar në Komitetin për Pronë dhe Urbanizëm dhe të gjitha kanë kaluar me shumicë të votave. Kemi ra në pajtim se të gjitha projektet janë të qëlluara dhe fitim prurëse për Komunën. Së pari me këto projekte bëhet rritje e numrit të punëtorëve në Komunë, mandej rritja e të hyrave komunale, ruajtje e planeve rregulluese dhe planeve zhvillimore të Komunës dhe krijimi i mundësive për investime, mandej krijohet mundësia e ndalimit të ndërtimeve pa leje. Mandej do të bëhet rritja e konkurrencës dhe zbritja e çmimit për m². Të gjitha këto asete deri më tash janë të pashfrytëzuara ose të shfrytëzuara shumë pak, si është rasti te Teatri.

Si kryesuese e komiteti kërkoj sqarime në këto pika: së pari të na raportohet para këshilltarëve ecuria para kualifikuese dhe çdo gjë të jetë transparente, sepse ne gjilanasit duhet të kemi një përparësi lidhur me marrëveshjet, kurse mbikëqyrja të jetë e nivelit shumë profesional, projektet të jenë ideore dhe zbatuese, pasta duhet të bëhet edhe revidimi i projektit nga ekspertët të cilat i ka Drejtoria e Urbanizmit. Kërkoj që të aprovohen këto projekte duke iu uruar sukses.

Ramiz Ramadani- ne e kemi dhënë shpjegimin tonë edhe në Këshillin e Ekspertëve dhe në Komitetin për Planifikim, por edhe njëherë po e shoh të arsyeshme ta përsërisim.

Jemi për çfarëdo investimi që ndodh në Komunë dhe është me interes për qytetarët tanë dhe zhvillimit ekonomik të Komunës. Ne kemi kërkuar që këto projekte të jenë në harmoni edhe me planin zhvillimor komunal dhe atë urban dhe me ato detale urbanistike atje ku janë.

Ajo që ne kemi kërkuar një sqarim në Komitetin për Planifikim është ajo te Ligji për PPP-i nenin 2, ku bëhet fjalë për investime dhe askund nuk parashihet investimi afarist banesor. As në këtë ligj ku janë afër 18 pika, as në Ligjin për koncesione në të cili ligjin definohet se si epet prona komunale. Në vijim të fjalës së tij z. Ramadani e lexon nenin katër dhe thekson se : “ unë nuk kam arrit ta di se si definohet kjo çështje?”. Kisha desh të marrë sqarime se me cilin ligj definohet kjo? Një dilemë të cilën kisha desh ta ngris dhe në analizën financiare që iu bëhet projekteve thotë pas përfundimit të projekteve do të ndahet cila pjesë i takon Komunës ose PPP-si dhe cila partnerit privat? Me këtë rast menjëherë e mënjanojmë pragun minimal dhe një prag minimal duhet të jetë një nga kriteret.

Arben Maliqi-në emër tim dhe të grupit tim së pari iu uroj zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryeministrit dhe kabinetit të tij. Gjithashtu e uroj edhe z. Rushitin i cili është person me vlera.

Mirëpo në emër të grupit tim po theksoj se ne parimisht e pranojmë këtë propozim-vendim, sepse është domosdoshmëri e kohës që kjo duhet të ndodh, por po e potencoj se nuk duhet të ngutemi, por as të vonohemi. Konkretisht duhet të bazohemi në Ligjin për PPP-në dhe duhet të punojmë konformë kësaj rregulloreje. Duhet të bazohemi në nenin 24 te kriteret e para të përzgjedhjes, pastaj në nenin 47 ku bëhet fjalë për asetet dhe në nenin 48, përvetësimi i të drejtave të cilat lidhen me lokacionin e projektit.

Unë do të koncentrohem në lagjen “Dardania I” dhe duhet ta them se kjo lagjeje dallohet prej të tjerave, sepse ajo pjesë e lagjes i takon qytetarëve të asaj lagjeje dhe ajo nuk është pronë e Komunës.

Për këtë arsye duhet të ketë edhe debate me qytetarët e asaj lagjeje, sepse ka shqetësime dhe pakënaqësi, por nuk janë kundër privatizimit dhe janë për këtë projekt. Mirëpo nuk janë që të ndërtohen disa markete, pastaj ndërtimi i lokaleve hotileiere, por edhe unë personalisht jam kundër ndërtimit të tyre. Aty duhet të ketë gjelbërim sa më shumë.

Te Kadastra është shumë në rregull, por si problem është tek ATK-ja dhe Kinemaja në të cilat institucione marrin pjesë tri subjekte, prandaj duhet të kemi kujdes dhe të bisedojmë edhe me qytetarët, pastaj te Grafikosi dhe ish Magjistratja ka edhe pjesë të cilat i takojnë edhe qytetarëve, sepse janë 5-10 shtëpi dhe aty duhet të bisedohet me qytetarë dhe ata të deklarohen se a janë të pajtimit apo jo?

Unë mendoj se duhet të ndodh ky privatizim, por duhet pasur kujdes që mos t' i lëndojmë qytetarët tanë.

Sokol Haziri- në lidhje me pikën e rendit të ditës për të cilën po debatojmë, grupi i ynë kemi qëndrim të qartë, sepse i njëjti ka kaluar nëpër filtrat e komiteteve të Kuvendit dhe kemi konstatuar se është marrë vlerësim pozitiv dhe pasi që kemi përgjegjësi publike dhe kemi ndikime në vlerësim të opinionit nuk do të kisha desh të flas me paragjykime në lidhje me zhvillimet e ardhshme. Projekti si i tillë është projekt i mirë dhe është mundësi e madhe dhe ndoshta e vetme që përmes investimeve publiko-private të lëvizet nga zero në këtë Komunë.

Ne si opozitë do të jemi shumë vigjilent në përcjellje të zbatimit të tërë të kësaj pune dhe do të dëshironim që i tërë ky proces të jetë në pajtim me ligjin që u thanë edhe nga parafolësit.

Si do qoftë unë e mendoj se duhet të jenë më të qarta miratimi i kriterëve dhe lokacionet që u përmenden duhet të definohen qartë. Ne duhet të debatojmë lidhur me lokacionet konkrete dhe me këto kriterë të marrim vendim.

Edhe një herë po e them se ne e deklarojmë votën për, por të kemi kujdes për ato që i thamë dhe të lirohemi njëherë e përgjithmonë prej paragjykimeve, sepse kemi nevojë për një paragjykim pozitiv.

Riad Rashiti- unë në emër të grupit të PDK-së po theksoj se ne kemi marrë qëndrim që të gjitha këto projekte t' i mbështesim, sepse janë respektuar të gjitha procedurat, por edhe është një nevojë e madhe për Gjilanin që të bëjmë investime të tilla të rëndësishme.

Kam një paqartësi te procedurat dhe kriteret me këtë propozim-vendimin i cili është përgatit.

Në faqe nr. 3 në pasuesin e parë, tek ofertuesit të cilët i plotësojnë kriteret e para kualifikimit ku thotë do të dorëzohen dokumentet për kualifikim vetëm pas ofrimit të dëshmisë për kryerje për 2% në emër të taksës të sigurimit të ofertës. Nëse kërkohet për çdo ofertë e cila është milionëshe, mesatarisht për një ofertues do të duhej 100 mijë euro duhet ta paguajë taksën në xhirollogari të Komunës. Kam pyetje a kthen ato mjete nëse ofertuesi nuk e fiton projektin? Kjo është një shumë e madhe dhe do të ketë edhe hezitime për konkurrim!

Por edhe tek kriteret financiare me numër gjashtë ku është garantimi i investimeve nga banka në 50% në nivel të investimeve, për të cilin rast mendoj se është një kriter i mirë shumë, por nuk e di sa është në përputhje me ligjin e prokurimit dhe tjetër kjo më duket se është një shumë tepër e madhe të cilën duhet ta paguaj investuesi dhe konsideroj se kjo do të jetë një pengesë, sepse me Ligj të prokurimit thuhet se duhet të jetë 10% sigurimi i ekzekutimit. Ka qenë mirë të korrigjohen këto gjëra dhe së paku të bëhen disa zbutje, ose të shkojmë në bazë të ligjit të prokurimit.

Tahir Arifi- edhe unë qëndroj pas asaj që tha Riadi, mirëpo nga ajo që e kemi debatuar në grupin tonë dhe nga bisedat që i kemi pasur me drejtorin dhe nga debatet që dëgjova nga kolegët, unë po e shohë se ka nevojë që edhe më tutje të bëhet një definim juridik për të këtë proces. Mua më duket se kjo është punë e Zyrës ligjore ose dikujt tjetër me kompetencë që këtë gjë definitivisht ta rregullojë.

Pasi që këto janë projekte ideore, do të dëshiroja që tek objekti i ATK-së të shqyrtohet edhe mundësia e funksionalizmit të disa hapësirave kulturore të cilat i mungojnë qytetit tonë. Mirëpo kam dëshirë të marrë një informatë për lagjen time në “Arbëria” ku është një hapësirë e madhe dhe e pashfrytëzuar dhe kam dëshirë ta di se ku mbet puna me një plan rregullues lidhur me atë hapësirë e cila do të ishte shumë e nevojshme.

Jashar Jashari – unë kam vetëm një pyetje lidhur me projektin në lagjen “Dardania” në të cilën lagje gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2009 është dhënë një premtim se në këtë lagje do të ndërtohet një qendër e QKMF-së e cila ide është mirëpritur nga qytetarët. Mirëpo në këtë projekt nuk figuron fare QKMF-ja. A do të realizohet ky premtim?

Riad Rashiti- një çështje e cila është ngrit shpeshherë në shumë komitete është ajo se a kemi ligj për investime për PPP-inë. Ata të cilët e kanë lexuar ligjin saktë thuhet se komuna për interesa të saja ka të drejtë të projektojë, të ndërtojë, të riparojë dhe jep në koncesion, prandaj këto projekte janë në përputhje me ligjin.

Izmi Zeka- për ta mënjeluar një dilemë e cila u debatuar këtu se a është kjo në përputhje me ligjin falën do t’ia jap fjalën Zyrës ligjore për të na dhënë sqarime.

Hevzi Matoshi- vendimin që e keni përpara është një vendim i cili cakton qartë kriteret mbi bazën e të cilit do të fillohet me investime të cilat janë paraparë. Në bazë të atij vendimi, baza ligjore është në ligjin për PPP-i, dhe në ligjet për marrëdhëniet pronësoresh –juridike. Mirëpo vlen të theksohet qartë se objekti i cili do të ndërtohet në “Dardani” është objekt i pastër në sferën e PPP-së. Objektet tjera të cilat janë të evidentuara për ndërtim, fillojnë me PPP-i, por përfundojnë me të drejtën për dhënie në shfrytëzim dhe rindërtim. Këtu pra është një procedurë e dyfishtë e të drejtës e cila implikohet pas përfundimit të objekteve.

Arben Mehmeti- unë edhe pas sqarimit nga Zyra ligjore, qëndroj prapa asaj se kjo fushë nuk e ka bazën ligjore për shkak të asaj se vet vendimi i KK-së bazohet në disa nene të ligjeve përkatëse të cilat nuk e rregullojnë fushën përkatëse, por më tepër i referohen pronarëve të paluajtshmërive.

Ligji mbi pronësinë e rregullon atë fushë dhe nuk e rregullon çështjen e pronësisë së Komunës për shkak, sepse në një formë edhe Komuna nuk e ka të drejtën ekskluzive që pronat t’i bartë diku tjetër, sepse kjo është e rregulluar me ligj dhe nuk e ka atë të drejtë për ta bartë të drejtën e banesave si shembull në afat të pacaktuar, ose sipas ligjit të PPP-së.

Unë mendoj se edhe vendimi është i shkruar gabimisht dhe është i bazuar në nenet përkatëse të ligjeve që nuk e rregullojnë çështjen për të cilën është shkruar këtu.

Këtu në vendim në disa nene është një kopje e Ligjit mbi pronën, kurse neni 271 vetëm është bartë te vendimi i Kuvendit, por këtu është edhe neni 9 i cili nen është te neni 271 i ligjit.

Unë konsideroj se edhe kjo është një plagjiaturë, sepse ka pasur vetëm bartje dhe për mua kjo është shumë diskutabile, sepse nëse thirrmi në ligj, duhet bërë saktësisht gjërat dhe të

theksohet neni. Mirëpo nuk ka të drejtë askush t'ia ndryshojë tretmanin, t'ia ndryshojë nenin ligjeve përkatëse dhe vetëm të bëjë ndonjë kopje.

Këtu është neni 9, ku është 271, kjo është kopje, te neni 10, është neni 273 të ligjit përkatës, neni 11, është kopje e nenit 274 dhe 275. Në këtë formë mendoj se edhe Zyra ligjore nuk e ka analizuar mirë këtë çështje.

Zyra ligjore në formë të ngutshme e ka sqaruar ligjin, por do ishte mirë që kjo zyre me një dokument të shkruar të na e adresojë neve këtë kërkesë tonën se a janë këto projekte në harmoni me ligjin dhe nëse ai arrin të na sjell këto kërkesa se në cilat neni është i bazuar ky projekt, atëherë edhe ne do ta votojmë dhe absolutisht nuk jemi kundër. Dokumenti si tillë për mua është skandaloz, sepse në disa vende edhe ligji është ndryshuar.

Unë jam për atë që të ndahen këto projekte dhe le të votohet secila zonë ndaras prej njëra tjetër si është "Dardania" e cila i ka disa defekte, por mund të miratohet. Gjithashtu edhe objekti te Kadastrri mund të kalojë edhe tek ATK-ja, ndërsa për të tjerat unë i rekomandoj Kuvendit në emër të grupit të këshilltarëve që t'ia hulumtoni edhe pak dokumentet, sepse do të jetë mirë edhe për investitorët. Për rastin e objektit të ATK i cili është objekt qeveritar është mirë të kemi edhe pëlqimin e MEF-it. Ne pajtohemi që këto projekte që i përmenda të kalojnë në këtë seancë për mos ta bllokuar punën e seancës, kurse për të tri tjerat të kompletohet dokumentacioni në baza legale dhe nëse na ofrohen në seancën e radhës Zyra ligjore me shkrim ne do ta votojmë dhe nuk jemi për të penguar asgjë, por vetëm kërkojmë të bazohemi në ligj.

Riad Rashiti- së pari po theksoj se z. Arbeni duhet ta lexoj ligjin dhe analizojë më mirë, kurse për atë që tha se nuk është e rregulluar me ligj, për derisa nuk është e ndaluar me ligj, Komuna ka të drejtë për interesa të saj të merr vendime jo në kundërshtim me ligjin, por në pajtim me ligjin.

Unë nuk e mbështesë propozimin që të bëhet ndarja e projekteve, sepse ato projekte kanë kaluar në komitet edhe në atë për Politikë dhe Financa dhe e ka marrë pëlqimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit. Unë mendoj se edhe pa vendim të Kuvendit, vetë banorët kanë të drejtë të bëjnë marrëveshje dhe të bëjnë ndërtime të reja.

Izmi Zeka- tek kriteriumet duhet të ketë ndryshime e sidomos te pika katër ku përmendet garazhimi 12%, 28%, dhe duhet të hiqet fjala e "okupuara", por edhe duhet hequr fjalën rast pas rasti dhe saktë duhet të jetë përqindja dhe kjo të definohet.

Unë mund t'ia falënderoj sponzoruesit, sepse është një punë edhe e ndjeshme dhe voluminoze dhe një punë shumë e dobishme për Komunën e Gjilanit.

Nuk jam për t'ia shtyrë, kjo patjetër duhet të kalohet, sepse nuk mund të humbim kohe edhe një apo dy muaj. Ne duhet të startojmë, por do të jemi të kujdesshëm nëse ka ndonjë devijim ne do ta rikthejmë në KK, por nuk guxojmë të ndalemi në këtë drejtim.

Nëse diçka bie në kundërshtim me ligjin, ju e dini që çdo vendim që merret në KK, menjëherë pasi që të nënshkruhet shkon në zyrën e MPL-së. MPL nëse konstaton se ndonjë vendim nuk është në pajtim me ligjin e kthen prapa me sqarime të duhura dhe na obligon që ta rishikojmë.

Qemajl Mustafa- unë iu falënderoj për debatet të cilat kanë qenë përmbajtjesore në të gjitha nivelet deri në këtë seancë. Ne kemi qenë fleksibil dhe tolerant, sepse kemi qenë të obliguar për ta shtrirë debatin sa më gjerë që është, sepse kjo është çështje me interes publik.

Këto projekte për të cilat sot po debatojmë janë investime të cilat nuk ndodhin në disa vite të ardhshme, por bazuar në materialet të cilat sot përdoren tek këto ndërtime dhe bazuar në atë se ndodhin në pjesën më urbane të qytetit janë së paku për 100 vitet e ardhshme.

Ne ende sot kemi ndërtesa që janë ndërtuar para 70-80 vjetëve e të cilat janë ende funksionale, por edhe të cilat janë ndërtuar me materiale të tjera shumë më të dobëta, por ende shfrytëzohen nga qytetarët. Ne kemi qenë të kujdesshëm, sepse së pari punën e kanë bërë profesionistët, por pjesa politike kemi dhënë instruksione që kjo të jetë e bazuar në ligj. Planet hapësinore dhe rregulluese janë kryer në këto zona, janë miratuar prej këtij Kuvendi. A janë kryer më së miri është gjithmonë përgjigja hipotetike, por janë miratuar këtu, profesionistët kanë punuar.

Unë nuk jam edhe i kënaqur me atë planin zhvillimor komunal, por ne kemi krijuar një bazë ligjore dhe planin rregullues po mundohemi për ta metalizuar për të mos mbet keq diçka.

Nuk duhet të qasemi në bindje dhe paragjykime personale tek këto zhvillime, sepse duhet grupet parlamentare duhet me i lanë në dorë individëve të cilët merren me këto çështje profesionale.

Ne sot po debatojmë dhe votojmë për principet e thirrjes së investimeve për kriteret për t' i ftuar investimet, sepse ende nuk e dimë a do të ketë investitorë për këto projekte.

Lidhur me pyetje që e bëri z. Jakupi për çështje të “Arbërisë”, kjo është përmendur vetëm në kuptim të kontestit, që investim i pastër PPP është “Dardania” dhe “Arbëria”, “Arbëria” është e asaj natyre, por ajo ende nuk ka hyrë si propozim, por ajo është në fazën e projektimit.

U tha nga Sabedini se është hequr “Henbdikosi”, por është heq për arsye tjetër, sepse po shihet se kur është liruar ajo zonë, “Hendikosi” ka qenë një ndërtesë e vogël me një përdhes dhe një kat e cila është zhvendos shumë shkujdesshëm, atëherë prej Drejtorisë së Urbanizmit të cilin unë e kam menaxhuar dhe unë kam qenë autokritik për veten time.

Është vendos në mes të zonës së lirë dhe do ta bënte atë hapësirë jo të shfrytëzueshme si duhet dhe joracionale. Kjo është arsyeje pse e kemi ndal atë ndërtim dhe e kemi vendos në një vend ku është finalizuar dhe do të bëhet inaugurimi këtyre ditëve. Është pranë rrugës qarkore të “Gllama” dhe mendoj se kemi bërë mirë, sepse atje iu kemi dhënë më shumë tokë. Aty do të ketë gjelbërim, do të ketë mundësi për pushim dhe rekreacion, kurse për kulturë dhe sport jo për shkak se kjo është zonë qendrore e qytetit.

Ne jemi marrë vesh që Çerdhen e cila po zhvendoset nga “Th. Mitko” do ta vendosim në përdhes, eventualisht ndoshta edhe në kat të parë të njëres nga ndërtesat, për ta shfrytëzuar maksimalisht hapësirën, dhe për mos të ndërtuar përsëri çerdhe për ta okupuar hapësirën.

U tha nga Florina, transparenca, mirëpo kjo ka qenë prej ditës së parë dhe do të jetë deri në fund dhe ajo do të jetë para këtij Kuvendi.

Mbikëqyrja do të jetë profesionale dhe do të jetë e kombinuar, mbikëqyrja do të jetë autonome e Komunës, por mbikëqyrës do të ketë edhe investitori, sepse ai investon shumë para.

Ne kemi qenë në takim me USAID-in Amerikan përmes një njësie e cila e përkrah PPP-inë në Prishtinë e cila ka qenë disa herë në Gjilan dhe ka desh ta shpejtojë procesin dhe për të parë se ku gjendet Komuna me këtë proces.

Kemi qenë në njësinë e ME-it dhe ata kanë konstatuar se ndërtimet nuk në bien pastër në PPP-i, sepse ai nuk i trajton këto, por ndërtimet afariste dhe banesore, por bien në domen të dhënies së pronës për dhënie në shfrytëzim për 99 vjet si i jep edhe AKP-ja, gjegjësisht bien në domen të Ligjit të pronës dhe të normativit komunal.

U bë pyetje për hapësirën në “Dardani”, ajo është hapësirë ndoshta për nga mënyra se si është kompensuar toka atje, është e banorëve të dy dardanive, por edhe mund të jetë ashtu! Mirëpo problemi është që nëse e lëshojmë atë hapësirë në menaxhim të qytetarëve, atje ose nuk ndodh asnjë zhvillim ose do të lindin konflikte nga më të ndryshmet. Ajo zonë nuk është e pastër private, ajo është e qytetarëve të Gjilanit, por pajtohem me atë që thotë z. Arbeni që të ketë debat më të gjerë.

Te “Grafikosi” është gjet modaliteti dhe këtë do ta debatojmë nëse ka të interesuar në detajim të kontratës, sepse është gjet modaliteti me ata banorë që jetojnë atje. Atyre iu kemi ofruar hapësirë më shumë se sa kanë në fakt, për t’i josh, sepse ata kanë jetuar gjatë aty dhe ato i kanë trajtuar si shtëpia të tyre. Në atë zonë nuk janë pajtuar vetëm 3 familje me arsyetim se e kanë lëndën në gjyq dhe do ta fitojë të drejtën e pronës për tokë. Ne këtë e kemi biseduar gjatë dhe kjo është aspekt i tejkaluar.

Z. Sokol Haziri tha diçka mbi mbikëqyrjen me të cilin pajtohem plotësisht, kurse Riad Rashiti, thotë se 2% është sigurimi i ofertës, por këto mjete kthehen. Këtë e kemi propozuar së bashku me 10% për ta pasur seriozitetin në punë, sepse këto janë zhvillime statike dhe gjithsecili nuk mund të marrë punë të këtij lloji. Ai cili nuk ka mundësi për ta siguruar ofertën me 2% për dy muaj ai nuk është serioz. Në 2 milion është 40 mijë euro, kurse në 3 milion është 60 mijë euro.

Kjo 50% është si garancion në bankë që këto mjete nuk mund të përdoren në destinim tjetër, kurse ne nuk ia bllokojmë paratë. Mirëpo 10% është garancion i yni dhe në shumën prej 2 milion euro asnjë investitor nuk i humb me dëshirë 200 mijë euro.

Tahiri e përmendi hapësirat kulturore tek ATK-ja, por do të jetë shumë vështirë, pasi që ne nuk kemi mjete tona vetanake, por edhe ai ndërtim dhe rrethim në hisen e Komunës do të jetë minore dhe nuk mund të kërkojmë shumë pjesëmarrje, sepse nuk do të ndodh investimi.

“Arbëria” është duke projektuar të cilën çështje me të drejtë e theksoi z. Tahiri i cili projekt është duke u bërë në vizionim në propozime të ndryshme nga qytetarët dhe përafërsisht edhe ky projekt do të jetë si “Dardania”.

Izmiu e përmendi kompensimin rast pas rasti, por kjo është e domosdoshme për shkak të specifikave të ndryshme që i kanë secili lokacion.

Komuna me këto projekte do të fitojë shumë në vitet dhe deceniet të cilat do të vijnë, Komuna e bën qytetin e ri, Komuna e bën infrastrukturën e re, Komuna punëson njerëz, dhe e rrit e ekonominë, por edhe fitojmë shumë në taksa.

Ne kemi punuar mirë dhe gjatë për këtë punë si pjesa ekzekutive ashtu edhe ajo politike dhe unë kërkoj që të kemi një koncenzues të plotë dhe ta votojmë, sepse krejt këto investime ndodhin për të mirën tonë, por edhe ju ftoj që t’i inkurajoni investitorët e mundshëm për të konkurruar.

Ramiz Ramadani- unë në emër të grupit parlamentar dëshiroj ta paraqes opinionin pasi që Arbeni nuk gjendet në sallë. Ne në asnjë çast nuk kemi qenë kundër këtyre projekteve dhe thjeshtë interesi i ynë ka qenë që investitorët të inkurajohen edhe për pikat tjera të cilin gjë e kam theksuar në komitet. Mirëpo pasi që kërkesa e shefit të grupit ishte që këto projekte të ndahen aty ku ka bazë ligjore do të votojmë, aty ku nuk ka bazë ligjore do të kundërshtojmë, ose të tërhiqemi, por pasi që këtu do të votohet në paket, edhe ne do ta mbështesim si grup, por me vërejtje të cilat janë esenciale.

Arben Maliqi- ne e falënderojmë kryetarin për një elaborim eksplicit të këtyre projekteve, por unë mendoj që këtu kemi një mos kuptim në mes meje dhe kryetarit. Unë nuk jam për mos humanizimin ose ndërtimin, por jam për atë që të bëhet një sqarim i mirëfilltë se çka do të ndërtohet në atë lagjeje dhe jam kundër ndërtimit të super marketeve, lokaleve afariste si dhe do të shohim se ajo do të marrë një kahe tjetër dhe do të shndërrohet në një kompleks të lokaleve afariste. Më vonë gjelbërimi do të zhduket, apo reduktohet.

Duhet t’i kujtoj të gjithë kuvendarëve, pse qytetarët e kësaj lagjeje “Dardania I”, kanë ditur shumë mirë që këtë lagje dhe fushë ta ruajnë edhe para luftës kur ka qenë shumë rrezik që aty të ndodh ndonjë degradim i asaj sipërfaqe, kurse tash duhet ta japin edhe mendimin e vet se çka

duhet të ndërtohet këtu. Edhe njëherë ne nuk jemi në asnjë mënyrë që ta ndalojmë punën, por duam ta dimë se çka po ndërtohet aty?

Izmi Zeka- këto gjëra janë debatuar, por ndoshta diku nuk ka pasur mirëkuptim, për shkak të ambicieve të ndryshme edhe për lokacion, por edhe për “Dardaninë” edhe gjëra të tjera.

Më bëri pak përshtypje pse nuk po ndalemi te kriteriumet? Ato do të jenë bazë për të ardhur investitorët, nëse kriteriumet nuk janë në nivel, po paragjykoj ose nuk janë të favorshme për ata, ata nuk vijnë! Unë qëndroj prapa asaj ashtu si e kanë propozuar grupi e ekspertëve, jo rast pas rasti dhe të jetë edhe 1%, por të dihet cili është interesi i Komunës?

Do të iu lus që t’i miratoni këto vendime që i posedoni:

1. Projekt-vendimi për caktimin e kriterëve dhe të procedurës për lidhjen e partneritetit publiko-privat dhe dhënien e të drejtës së ndërtimit në pronën komunale
2. Vendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik, (lagjja “Dardania”)
3. Vendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik, (objektit te Kadastrit)
4. Vendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik, (objekti përball Drejtorisë për Urbanizëm)
5. Vendimi për caktimin e lokacionit për qëllim të interesit publik, (objekti afarit-banesor-Iliria)

Këtu nuk janë edhe dy projekte për qendrën te Argjendaria, për ATK-në dhe Magjistralen, por këtu do t’i propozojmë në seancën e ardhshme pasi t’i përgatisim.

Ju lus të deklaroheni se kush është për aprovimin edhe të kriterëve edhe për përcaktimin e këtyre lokacioneve për katër objekte sipas listës së projekteve?

Aprovohet propozim-vendimi 3/1 me 38 vota të anëtarëve të Kuvendit , 1(një) kundër dhe 1 (një) abstenim

3/2- Propozim- vendimi për aprovimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit dhe komiteteve të KK-Gjilan për vitin 2011

Izmi Zeka- si pikë e rendit të punës është orari i takimeve të Kuvendit dhe të komiteteve, por këtë duhet kuptuar se ky orar mund të lëviz, por orientimishtë ne do ta kemi një kalendar se kur do të mbahen takimet.

Kush është për aprovim të këtij orari?

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 3/2 e rendit të punës

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA